

VENDIM
Nr.787, datë 16.11.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS FUSHË-BULQIZË, TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Fushë-Bulqizë, të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Fushë-Bulqizë, miratuar me vendimin nr.727, datë 23.11.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Fushë-Bulqizë, të qarkut të Dibrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Fushë-Bulqizë për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Fushë-Bulqizë

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-6	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
7-9	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
10-12	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive kulturore	Në pronësi
13-44	Varrezat publike	Në pronësi
45-50	Prona që përdoren për zhvillim ekonomik	Në pronësi
51-54,59,60,61,62,65,66,70,71	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë	Në përdorim
55-58,63,64,67.68.69,72-74	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit toka joproductive	Në pronësi
76-323	Pyje dhe kullota	Në pronësi
330-506	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
507-509	prona që shërbejnë për furnizimin me ujë të pijshëm, ujësjellësa	Në pronësi